



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

APLIKACIONI PËR MEKANIZËM BUJQËSOR 2019

I. Të dhënat e aplikuesit

Nr. _____

Emri		Emri i Prindit		Mbiemri	
------	--	----------------	--	---------	--

Nr. Personal i letërnjoftimit																	
----------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

II. Adresa

Komuna	
--------	--

Vendbanimi/rrugë	
------------------	--

Telefoni																		e-mail	
----------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--------	--

III. Data:		(Data/Muaji/Viti)
------------	--	-------------------

IV. Aplikacioni është komplet	PO ☐	JO ☐
vetëm për përdorim zyrtar (plotësohet nga Zyra Komunale)		

Llojet e Mekanizmave Bujqësor Kërkesa primare	Llojet e Mekanizmave bujqësor Kërkesa sekondare	Llojet e Mekanizmave bujqësor Kërkesa terciare
- Shpërnadrese plehu - Plugje dy krahëshe - Motokultivator(Benasi) - Makinë Mjelëse - Koshere për Bletë - Gërsher për Vreshta - Kultivator(plugje për vreshta) - Gërsher për qethje deleve dhe dhi - Pompa për ujitje - Frezë (1.6m-1.8m,3.0m) - Mulqera për hardhi - Automizer(spërkatëse për vreshta)	- Shpërnadrese plehu - Plugje dy krahëshe - Motokultivator(Benasi) - Makinë Mjelëse - Koshere për Bletë - Gërsher për Vreshta - Kultivator(plugje për vreshta) - Gërsher për qethje deleve dhe dhi - Pompa për ujitje - Frezë (1.6m-1.8m-3.0m) - Mulqera për hardhi - Automizer(spërkatëse për vreshta)	- Shpërnadrese plehu - Plugje dy krahëshe - Motokultivator (Benasi) - Makinë Mjelëse - Koshere për Bletë - Gërsher për Vreshta - Kultivator(plugje për vreshta) - Gërsher për qethje deleve dhe dhi - Pompa për ujitje - Frezë (1.6m-1.8m-3.0m) - Mulqera për hardhi - Automizer(spërkatëse për vreshta)
Aplikuesi /Fermeri _____	Zyrtari Komunal _____	



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 465 Më 26.04 2019
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje e fermerëve me mekanizëm bujqësor

Rahovec, Prill 2019

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural fton të gjithë fermerët e Komunës së Rahovecit që të aplikojnë për grante të vogla në mekanizëm bujqësor.

• **Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë:**

1. Pemëtaria (vreshtaria),
2. Lavërtaria,
3. Perimekultura,
4. Blegtoria,
5. Bletaria.

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e grantit janë:

- Të jenë banor të Komunës së Rahovecit,
- Të kenë të shlyera obligimet ndaj Komunës,
- Të jetë i gatshëm / e gatshme të nënshkruaj kontratë me kushtet e Komunës
- Të posedojnë tokë bujqësore në pronësi apo të marr me qira,
- Të mos jetë përfitues i granteve komunale në tre vitet e fundit,
- Të jetë i gatshëm të financoj 20% të vlerës së pajisjes,
- Fermerët mund të aplikojnë deri në tre pajisje, por mund të jetë përfitues vetëm i një pajisje.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Aplikacioni (merret online ose në zyrat e DBPZHR-së),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Dëshmi mbi pronësi të tokës bujqësore,
- Vërtetim mbi shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës së Rahovecit (Tatim në pronë dhe taksë komunale).

1. Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Shpërndarësës së Plehut apo Plugje (2 krahësh):

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë fermer/fermere, kultivues i kulturave lavërtare dhe perimore.
- Të ketë të mbjell kulturat lavërtare, si: Grurë, Misër, Elb apo Tërshërë së paku **0.50ha**
- Të ketë të mbjellë së paku **0.20ha** me perime, sipërfaqe e përgjithshme duhet të jete **0.50ha** me perime.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimit Motokultivator (Benasi):

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë fermer/fermerë, kultivues i kulturave vreshtarë dhe perimore.
- Të ketë të mbjellë së paku **0.50ha** me vreshta apo **0.50 ha** me perime

3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimit Makinës Mjelëse:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të posedojë lopë qumështore (së paku 3 lopë)
- Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së

4. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimit të Koshere për Bletë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë anëtarë i shoqatës së Bletarëve,
- Të ketë së paku 10 koshere,
- Të ketë vërtetimin e deklarimit të numrit të bletëve dhe lokacionin, lëshuar nga DBPZHR

5. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët (vreshtarët) për përfitimit Gërshërë dhe Kultivator (plugje për vreshta):

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të ketë së paku 0.20 ha me vreshta,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta

Për Gërshërë:

1. Sipërfaqe nga 0.20 ha deri 0.50 ha përfitojnë 1 palë Gërshërë
2. Sipërfaqe nga 0.51 ha deri 1.00 ha përfitojnë 2 palë Gërshërë
3. Sipërfaqe nga 1.01 ha deri 3.00 ha përfitojnë 3 palë Gërshërë
4. Sipërfaqe mbi 3.00 ha përfitojnë 4 palë Gërshërë

6. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimit: Gërshërë për qethjen e deleve dhe dhi:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të kenë numrin e dele/dhi së paku 10 krerë
 - Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së
- Gërshërë për qethjen e deleve dhe dhive:
1. Prej 10 krerë deri 100 krerë , përfitojnë 1 palë gërshërë
 2. Prej 100 deri 300 krerë, përfitojnë 2 palë gërshërë
 3. Prej 300 e më shumë, përfitojnë 3 palë gërshërë

7. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e pompave për ujitje:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojnë tokë bujqësore së paku 0.50 ha,
- Të jetë nga zona ku nuk është i shtrirë sistemi i ujitjes,
- Të ofroj dëshmi mbi burimet e ujit për furnizim.

8. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Frezë për traktor:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojnë tokë të punueshme bujqësore së paku 5 ha,
- Të ketë kulturat: Lavërtari, Perimekulturë, Vreshtari dhe Pemëtari.

9. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e pajisjes për Mulqerimin e hardhive:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedoj vreshta së paku 2.00 ha,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta.

10. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e pajisjes Automizer (Stërpikëse):

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedoj vreshta së paku 2.00 ha apo perime mbi 2 ha,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta.

Vërejtje:

- *Për arsye të numrit të kufizuar në një lloj të pajisjes, fermeri e merr të dytën apo të tretën sipas prioritetit që e përcakton në aplikacion,*
- *Përqindja e përkrahjes do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit dhe 20% nga fermeri,*
- *Pasi të shpallen përfituesit, të gjithë fermerët janë të obliguar që ta kryejnë participimin prej 20% dhe të nënshkruajnë kontratën me Komunën e Rahoveci.*

Afati i aplikimit nga data: **30.04.2019** deri më **24.05.2019**

Aplikacionet dorëzohen në zyrën nr. 3 në drejtorinë e BPZHR-së, në objektin e vjetër të komunës së Rahovecit.